

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)69 22 40 906
E-mail: info@qkzh.org

Rezultatet e vrojtimit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 16, qershor 2005

www.qkzh.org

Business and Consumer
Survey Results
No 16, March 2005

Në këtë numër:
Zhvillimet në sektorin e industrisë
përpunuese dhe ndërtimit



In this number:
Development in manufacturing
and construction sector

KLIMA E BIZNESIT/ BUSINESS CLIMATE


Klima e biznesit në industri: është optimiste
Business climate in manufacturing sector: is optimistic.

Vlerësimet e anketës në muajin prill tregojnë një rritje të **treguesit të besueshmërisë** në sektorin e industrisë përpunuese prej 13 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, ç'ka flet për një parashikim optimist të situatës së biznesit në 3-mujorin e dytë të vitit 2005 (shiko figurën 1). Ky tregues ruan gati të njëjtën vlerë të balancës në përqindje krahasuar me një vit më parë.

Klima e biznesit në ndërtim: mbetet pozitive
Business climate in construction sector: remains positive


Treguesi i besueshmërisë në sektorin e ndërtimit është rritur nga janar 2005 në prill 2005 me 27 pikë, duke ruajtur nivele relativisht të larta krahasuar me rezultatet e prillit dhe korrikut të vitit 2004. Balanca në përqindje e këtij treguesi në prill 2005 shënon dhe vlerën më të lartë gjatë periudhës së anketimit prill 2002 – prill 2005 me 36 pikë.

FIGURA 1 : Treguesi i QKZH për besueshmërinë në industrinë përpunuese
CRD Confidence indicator in manufacture




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 2: Treguesi i QKZH për besueshmërinë në sektorin e ndërtimit
CRD confidence indicator in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Indikator i besueshmërisë së NVM-ve tregon se mjedisi i biznesit për ndërrmarjet e mesme ka qënë në përgjithësi pozitive dhe se klima e biznesit është më e favorshme për këte grup se për dy grupimet e tjera. Të treja grupimet e ndërrmarjeve ndikohen pak a shumë nga të njëjtët faktorë kufizues dhe sezonalë. Rezultatet e anketimit të prill 2005 tregojnë për një përmirësim të klimës së biznesit vecanërisht për firmat e vogla dhe të mesme.




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2005 biznesi në sektorin e industrisë përpunuese duket se ka pësuar një rënie në aktivitetin prodhues në krahasim me 3-mujorin e fundit të vitit 2004. Në muajin prill 2005 balanca e përgjigjeve mbi **aktivitetin e prodhimit në 3 muajt e kaluar** shënon vlerën negative prej 24 pikësh. Ky nivel në përqindje është 33 pikë më i ulët se 3 muaj më parë dhe 10 pikë më i ulët se një vit më parë.




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Treguesi i parashikimit të biznesit në 3 muajt e ardhshëm shënon një rritje të ndjeshme prej 50 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë. Balanca e përgjigjeve në përqindje për këtë tregues tregon qartë se biznesmenët parashikojnë rritje të aktivitetit të biznesit në 3 muajt e ardhshëm, megjithëse kjo rritje e parashikimeve të tyre nuk mbështetet me një nivel të kënaqshëm të treguesit të kontraktimeve (shiko figurën 5).




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Parashikimi i punësimit për tre muajt në vazhdim në bazë të balancës të përgjigjeve në përqindje prej 31 pikësh në prill 2005 tregon për një rritje të fuqisë punëtore në sektorin e industrisë përpunuese. Drejtuesit e firmave janë mjaft optimistë në rritjen e këtij treguesi krahasuar me pothuajse gjithë periudhën e anketimit të biznesit. Në prill 2005 kemi një rritje me gati 32 pikë nga tremujori i fundit.




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 7 : Vlerësimi i kontratave për export në sektorin e industrisë përpunuese
Assesment of export order-books in manufacture - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 8 : Parashikimi i kontratave për export në industrinë përpunuese
Export expectation in manufacture - total




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 9 : Vlerësimi i çmimeve të shitjes në industrinë përpunuese
Assesment of selling prices



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 10 : Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese në industrinë përpunuese
Capacity utilisation in manufacture - total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Niveli kontraktiveve është në nivele jo të kënaqshme edhe në muajin prill 2005. Balanca e përgjigjeve për këtë tregues është puthuajse i pandryshueshëm për dy 3-mujorët e kaluar.

Po kështu në nivele jo të kënaqshme janë edhe **kontratat për eksport**. Ky tregues shënon vlerën negative prej 24 % i cili është 19 pikë më i ulët se 3 muaj më parë. Kjo tendencë negative për eksportet konstatohet që prej tetorit 2004.

Megjithatë drejtuesit e firmave që kanë aktivitet në ekport janë optimiste në lidhje me **parashikimin e kontratave të eksportit për 3 muajt e ardhshëm** (shiko figuren 8). Kjo duket me rritjen e dukshme të balancës së përgjigjeve për këtë pyetje me 22 pikë në krahasim me rezultatet e muajit janar, gjë që tregon se eksportet kanë shanse të rriten gjatë 3-mujorit të dytë të vitit 2005.


Parashikimi në rritje i aktivitetit të prodhimit me sa duket do të çojë drejtuesit e ndërmarrjeve të rrisin nivelin e çmimeve për produktet. Kjo duket në figuren 9 ku balanca e përgjigjeve në lidhje me **parashikimin e çmimeve të prodhimeve** shënon një rritje prej 28 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë.

Kapacitet prodhuese gjatë 3-mujorit të parë janë shfrytëzuar pothuajse në të njëjtat nivele si në fund të vitit 2004, prej rreth 56 %. Këto nivele janë mjaft të ulta, duke e krahasuar këtë nivel me shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese nga firmat në Evropë ku ky tregues arrin nivelet prej 75-85 %. Nga vlerësimet e QKZH-së është konstatuar se nivele të ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese ekzistojnë kryesisht tek firmat mikro dhe ato të vogla (me deri në 50 punonjës).

Pengesat në sektorin e industrisë përpunuese *Constraints within manufacturing sector*

Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i brendshëm është në nivele relativisht të ulëta, dhe me sa duket nuk është faktori kryesor pengues për ecurinë e deritanishme të firmave industriale. Ky faktor përmendet nga 23 % e të intervistuarve, me një rritje të lehtë prej 3 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë (shiko figurën 11).


FIGURA 11: **Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu brënda vendit**
Insufficient domestic demand-total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe zhvillim, Tiranë

Figura 12 tregon se **kërkesa e pamjaftueshme nga tregu i jashtëm** përbën një shqetësim për firmat në industrinë përpunuese, duke u përmendur nga 35% e të anketuarve, me një rritje prej 13 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë. Vlera e prill 2005 përbën dhe vlerën më të lartë në përqindje të kësaj pengese për sektorin e industrisë përpunuese që nga janar 2002.


FIGURA 12: **Ndikimi i kërkesës së pamjaftueshme nga tregu i jashtëm**
Insufficient foreign demand-total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Mungesat e energjisë elektrike përbëjnë një shqetësim konstant për menaxherët dhe drejtuesit e firmave të intervistuar për vitin 2005. Kjo pasi ky faktor përmendet nga 63 % e të intervistuarve, me një tendencë rritjeje në 6-muajt e fundit. Ky nivel është rreth 10 pikë më i ulët se një vit më parë dhe gjithashtu më i ulët se mesatarja 2002-2004 për këtë tregues (shiko figurën 13).

FIGURA 13: **Ndikimi i mungesës së energjisë elektrike**
The impact of shortages on electricity in manufacture - total



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë


Zhvillimet në sektorin e Ndërtimit Development in Construction sector

Indikatori i besueshmërisë së NVM-ve për ndërrmarjet e vogla dhe vecanërisht për mikro ndërrmarjet është negative për tremujorin e fundit respektivisht me 10 dhe -21 pikë. Prej janar 2004 klima e biznesit për këtë grup ndërrmarrjesh nuk shënon rritje. Aktualisht indikatori i besueshmërisë (shiko figurën 14) për ndërrmarjet e mesme është në nivele pozitive me 23 pikë në prill 2005 dhe është pak më i lartë krahasuar me një vit më parë.

Kontraktimet janë gjykuar nga menaxherët e firmave si të mjaftueshme për vazhdimësinë e aktivitetit të tyre. Balanca e përgjigjeve pozitive me ato negative është 10 pikë në muajin prill 2005 dhe është 7 pikë më e lartë se vlerësimi i kontraktimeve në muajin janar 2005. Figura 15 tregon se kemi një rritje në vlera në tre tremujorët e fundit në krahasim me prillin dhe korrikun e 2004.


Vlerësimi i kontraktimeve është një nga treguesit që ne përdorim për të llogaritur indikatorin e besueshmërisë në sektorin e ndërtimit. Figura 16 tregon se niveli i pamjaftueshëm i kontraktimeve për ndërrmarjet e vogla dhe mikro-ndërrmarjet në sektorin e ndërtimit reflekton klimën pesimiste të menaxherëve sidomos për 2004 por gjithashtu dhe për dy tremujorët e parë të 2005. Pas korrik 2004 ka shënja të përmirësimit të nivelit të kontraktimeve për ndërrmarjet e mesme.

FIGURE 14: Indikatori i besueshmërisë së NVM-ve në sektorin e ndërtimit, 2002-Prill 2005
CRD confidence indicators of SME-s in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 15 : Vlerësimi i nivelit të kontratave në sektorin e ndërtimit
Assessment of order-books



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURE 16: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve për NVM-te në sektorin e ndërtimit, 2002-Prill 2005
Assessment of order books for SME-s in construction sector




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Duke ndjekur *parashikimet* e pronarëve të firmave ndërtuese, shikohet se *punësimi* ka rritje në periudhën në vazhdim. Nga përgjigjet e të intervistuarve në prill 2005 është shënuar dhe vlera më e lartë e këtij treguesi me 36 pikë që prej prillit të 2002-shit pas një periudhe gati të njëjtë vleresimi që fillon nga korrik 2003 deri në janar 2005 (shiko figurën 17). Në raport me mesataren 2002 – 2004, parashikimi i punësimit për tremujorin e ardhshëm është gati 36 pikë më e lartë.

Treguesi i *ecurisë së aktivitetit të ndërtimit* në 3 muajt e fundit tregon për mundësinë e rritjes së aktivitetit të ndërtimit në tre 4-mujorë të njëpasnjëshëm. Vlera në përqindje prej 20 pikësh në prill 2005 edhe pse ka një rënie të lehtë nga tremujori i kaluar mbetet në nivele pozitive. Në krahasim me mesataren 2002-2004 indikatori i vlerësimit të aktivitetit të ndërtimit në muajin prill 2005 është mbi këtë mesatare.


Balanca e përgjigjeve të menaxherëve dhe pronarëve të firmave të ndërtimit në lidhje me *parashikimin e cmimeve* të ndërtimit tregon një rritje prej 46 pikësh në krahasim me 3 muajt më parë. Pas një rënie të këtij treguesi në janar 2005 ku menaxherët e firmave mendonin në mbajtjen e cmimeve të ulta dmth sa më konkurrencte shfaqet sërish tendenca e rritjes së cmimeve në sektorin e ndërtimit.

FIGURA 17: Parashikimi i punësimit për tre muajt e ardhshëm në sektorin e ndërtimit
Employment Expectation in construction sector (next 3 months)




Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 18: Vlerësimi i aktivitetit të ndërtimit në tre muajt e fundit
Assessment of business activity in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 19: Parashikimi i çmimeve të ndërtimit
Price expectations in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

Pengesat në sektorin e ndërtimit *Constraints within construction sector*


Më poshtë do të paraqiten faktorët kryesorë pengues që u evidentuan gjatë kryerjes së anketimit të fundit. Ndikimi i **mungesës së energjisë elektrike** është evidentuar si një nga faktorët më pengues nga menaxherët e firmave të ndërtimit. Në prill 2005, ky faktor përmendet nga 49% e të anketuarve dhe ka pësuar një rënie të lehtë prej një pike në përqindje krahasuar me tre muaj më parë (shiko figurën 21).

Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit vazhdon të ruajë vlera të larta në përqindje dhe veçohet si një nga faktorët më pengues. Në anketimin e fundit ky faktor përmendet nga 63 % e të intervistuarve. Pavarisht se kemi një rënie prej 5 pikësh në përqindje në krahasim me vlerën e prill 2005 sërish ky faktor është mjaft shqetësues për menaxherët e firmave.

Në sektorin e ndërtimit **ndikimi i faktorëve makroekonomikë** ka pësuar rënie për prill 2005 krahasuar me vlerën në përqindje të tre muajve më parë me rreth 20%. Prapëseprapë ky faktor përmendet nga rreth 40% e të intervistuarve në anketimin e fundit duke shprehur kështu një nga shqetësimet kryesore të drejtuesve në sektorin e ndërtimit.

FIGURA 20 : **Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike në sektorin e ndërtimit**


The impact of shortages on electricity in construction sector



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 21 : **Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e ndërtimit**


The impact of financial legislation



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

FIGURA 22 : **Ndikimi i faktorëve makroekonomikë në sektorin e ndërtimit**

The impact of macroeconomic factors in construction sector -



Burimi: Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë

TË PËRGJITHSHME

Gjatë anketimit të muajit prill 2005 u kontaktuan 500 firma në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit në rrethet Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan dhe Shkodër, nga të cilat u përgjigjën brënda periudhës së anketimit, 484 firma.

Anketimi i biznesit në sektorin e industrisë përpunuese dhe ndërtimit ka filluar në muajt janar dhe prill të vitit 2002. Anketimi bazohet mbi vlerësimin cilësor të opinioneve të menaxherëve apo pronarëve të ndërmarrjeve të kontaktuara. Vlerësimet cilësore përpunohen në formën e treguesit të Balancës, e cila shpreh diferencën midis përgjigjeve optimiste (në rritje, apo përmirësim) kundrejt atyre pesimiste (në ulje, apo përkeqësim) duke përjashtuar nga vlerësimi opinionet që shprehin situatë të pandryshuar. Në këtë mënyrë kur balanca e përgjigjeve është pozitive vlerësimet e optimistëve tejkalojnë ato të pesimistëve dhe në të kundërtën do të kishim një balancë negative. Duke ndjekur të njëjtën praktikë për periudha rigorozisht të përcaktuara (mujore apo tremujore), mbi bazën e balancave ndërtohen indikatorë të caktuar të biznesit që shprehin situatën e biznesit në raport me periudhat e mëparshme, situatën aktuale dhe

parashikimin për një periudhë të paktën 3 mujore. Anketimet e biznesit shërbejnë, gjithashtu, jo vetëm për të ndjekur tendencën e biznesit, por me anë të tyre diktohen ciklet e biznesit, si dhe pikat e kthesës në ciklin e biznesit.

Kjo metodë anketimi zbatohet në të gjitha vendet e Bashkimit Europian dhe vendet Kandidate, si dhe me pak ndryshime në të gjitha vendet anëtare të OECD-së. Në Europë, instituti i parë që ka filluar anketimet cilësore të biznesit është Instituti IFO në Munihi të Gjermanisë (viti 1949). Për traditën e gjatë të këtij instituti, treguesi i besueshmerise (apo konfidencës) në Gjermani njihet ndryshe edhe si IFO indeks. Në botë treguesi i besueshmerise së biznesit (së bashku me ato të konsumatorëve) janë treguesit më të ndjekur jo vetëm nga bota e biznesit, por edhe nga institucionet publike si bankat qendrore etj. Për rëndësinë e tyre në Europë këto indekse monitorohen drejtpërsëdrejti nga Komisioni Europian - Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomi-Financës, prej së cilës merr gjithashtu asistencë të drejtpërdrejtë edhe Qendra për Kërkim dhe Zhvillim, Tiranë.

QENDRA PER KERKIM DHE ZHVILLIM CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

QKZH është një organizatë jo fitimprurëse dhe jo partiake e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 27/03/2001. Qëllimi i QKZH është kryerjave e studimeve dhe analizave ekonomike rreth zhvillimeve dhe performancës së biznesit nëpërmjet anketimeve periodike. Duke analizuar poblematikat e biznesit dhe publikut dhe shpërndarjen e rezultateve synohet të ndihmohen institucionet publike dhe komuniteti i biznesit për të përcaktuar politika më të mira që i shërbejnë përmirësimit të jetës të të gjithë qytetarëve.

CRD Tirana is an independent, non-profit and non-partisan organisation, duly registered at the Court of Tirana in 27.03.2001. The aim of CRD is to create and disseminate knowledge about economic development and business performance to help public institutions and business community to designate good policies for a better society. The CRD conducts business and consumer surveys, organises meetings and publish research results about recent business development, factors limiting production activity and future investment.